

**NJOFTIM**  
**Nr. 3294, datë 28.7.2023**

**PËR RISHPALLJEN E 1 (NJË) VENDI VAKANT PËR POZICIONIN E  
KËSHILLTARIT EKONOMIK NË KOMISIONIN E PAVARUR TË KUALIFIKIMIT**

Në zbatim të nenit 22, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit rishpall fillimin e procedurave për personat e interesuar që kërkojnë të aplikojnë për pozicionin e Këshilltarit Ekonomik, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, kategoria e pagës: 80% e G3.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:**

a) Të kenë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare në shkenca ekonomike, matematike ose në drejtësi, me diplomë “Master i shkencave” në Shqipëri, ose studimet universitare për shkenca ekonomike, matematike ose në drejtësi jashtë vendit dhe të jetë e njësuar sipas legjislacionit në fuqi për njësimin e diplomave;

b) Të zotërojnë shumë mirë gjuhën angleze;

c) Të kenë shtatë vjet përvojë pune në sektorin financiar.

**Kushte të përgjithshme:**

- Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret për t’u pajisur me certifikatë sigurie, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015;

- Ndaj tyre të mos jetë nisur procedim penal, të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kundërvajtjeje penale;

- Ndaj tyre të mos jetë marrë masë disiplinore me largim nga detyra ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit në momentin e aplikimit;

- Kandidatët duhet të kenë aftësi për t’u përshtatur e për të punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

**Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:**

1. Kërkesë me shkrim, shprehje interesi;

2. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;

3. Kopje të dokumenteve (diplomë, letërnjoftim, librezë pune (origjinale ose të noterizuara));

4. Dëshmi penaliteti;

5. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

6. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe në trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Aplikimet duhet të dorëzohen brenda datës 8.9.2023 pranë institucionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në adresën: Rruga e Kavajës, ish-Lidhja e Shkrimtarëve, Tiranë, zyra e protokollit, nga e hëna-të premte, ora 08:30–17:00, ose nëpërmjet postës elektronike, në adresën: [info@kpk.al](mailto:info@kpk.al), i cili konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.